

## **AKTI I THEMELIMIT**

### **DHE**

### **STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“FoodWill SHPK”**

*Ortakët e Shoqërisë:*

1. Z. Edjon Doçi, shtetas i Republikës së Shqipërisë, lindur më 29.06.1986, në Macukull, Mat, me pasaportë nr. BJ6221551, ID: 031743568, me vendbanim në adresën: rruga Don Bosko, kompleksi Vizion Plus, hyrja 2, ap. 47, Tiranë, Republika e Shqipërisë, zotërues i 45% të kapitalit të Shoqërisë, e-mail: edidoci@hotmail.com;
2. Z. Dmitry Shubin, i biri i Viktorit, shtetas i Federatës Ruse, lindur më 11.11.1972, në Moskë, me pasaportë nr. 4518351344, me vendbanim në adresën: bulevardi Samarkandski, pall. 15, hyrje 1, ap. 110, Moskë, Federata ruse, zotërues i 45% të kapitalit të Shoqërisë, e-mail: dmi7708@yandex.ru;
3. Z. Levon Gevorgyan, i biri i Rudolfit, shtetas i Republikës së Armenisë, lindur më 08.09.1981, në Erevan, me pasaportë nr. AT0484470, me vendbanim në adresën: rruga Fuchika, pall. 21, ap. 1, Erevan, Republika e Armenisë, zotërues i 10% të kapitalit të Shoqërisë, e-mail: mollev@yandex.ru;

### **KAPITULLI I**

#### **1. Neni 1. Emri i shoqërisë**

1.1. Emri i plotë i Shoqërisë – shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “FoodWill” (në vijim “Shoqëria”); forma e shkurtuar e emërtimit të Shoqërisë “FoodWill SHPK”, që përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themelohet në datën e nënshkrimit të këtij akti.

1.2. Ortakët e Shoqërisë gjëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e Shoqërisë të përfaqësuar në kuota

1.3. Shoqëria mund të përdorë dhe lëshojë letër-format standard, numër llogarie, vulë dhe vërtetime, si dhe në të gjitha dokumentet, faturat, njoftimet dhe aktet e lëshuara prej saj, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, Shoqëria do të përfshijë dhe paraqesë të dhënat më poshtë:

- (i) fjalët “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “Shpk”;
- (ii) numrin unik të identifikimit të biznesit (NUIS);
- (iii) adresën e selisë;dhe
- (iv) vlerën e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, duke përcaktuar vlerën e pjesës së paguar të kapitalit.

#### **2. Neni 2. Forma Ligjore**

2.1. Shoqëria është një entitet ligjor, e krijuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (“shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”), në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe

shoqëritë tregtare”, të ndryshuar sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë (“Ligji i shoqërive”).

### **3. Neni 3. Selia**

3.1. Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr. Don Bosko, Kompleksi Vizion Plus, hyrja2, ap. 47, Tiranë, Republika e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi Brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë.

### **4. Neni 4. Kohëzgjatja**

4.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

## **KAPITULLI II**

### **5. Neni 5. Qëllimi dhe objekti i Shoqërisë**

5.1. Qëllimi i veprimtarisë së Shoqërisë është realizimi i fitimit.

5.2. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është:

- Bar - kafe
- Shërbime reklamimi në formë elektronike;
- Tregtim;
- Shërbime ndërmjetësimi (shoqëruese)

### **6. Neni 6. Ndryshime**

6.1. Shoqeria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarise së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

## **KAPITULLI III**

### **7. Neni 7. Kapitali Themeltar dhe Pjesëmarrja/Kuota**

7.1. Kapitali i Shoqërisë me krijimin e saj është 5,000 USD (pesë mijë dollarë amerikanë), i konvertuar në lekë me kursin e Bankës së Shqipërisë në ditën e nënshkrimit të këtij akti, që përbën: - vlerën **575,000 lekë (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë lekë)**. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët si vijon:

- 1) Z. Edjon Doçi, i cili zotëron 45% (dyzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- 2) Z. Dmitry Shubin, i biri i Viktorit, i cili zotëron 45% (dyzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- 3) Z. Levon Gevorgyan, i biri i Rudolfit, i cili zotëron 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

7.2. Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me pjesëmarrjen në kapitalin e Shoqërisë nga secili prej ortakëve siç parashikohet në pikën 7.1 më sipër dhe përbëhet nga:

- 1) Z. Edjon Doçi 258,750 (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë;
- 2) Z. Dmitry Shubin, i biri i Viktorit 258,750(dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë;
- 3) Z. Levon Gevorgyan, i biri i Rudolfit 57,500 (pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë.

7.3. Shlyerja e pjesëmarrjes përkatëse në kapitalin e Shoqërisë kryhet brenda afatit dhe në formën e përcaktuar me vendim të organit ekzekutiv (administratorit) të Shoqërisë.

7.4. Secili prej ortakëve të Shoqërisë ushtron të drejtën e votës në proporcion me vlerën e kontributit të shlyer në kapitalin e Shoqërisë, sipas pjesëmarrjes përkatëse.

7.5. Në rastet kur vendimi i asamblesë së përgjithshme të ortakëve për zmadhimin e kapitalit, vendos edhe mbi afatin dhe formën e shlyerjes së kuotave, atëherë administratori duhet të zbatojë këtë vendim.

## **8. Neni 8. Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

8.1. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të:

- aktiveve të Shoqërisë;
- kontributeve në para ose kontributeve në natyrë të ortakëve të Shoqërisë;
- kontributit të personave të tretë në kapitalin e Shoqërisë;
- kapitalizimit të borxhit

bazuar në vendimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve të Shoqërisë, Ligjit për shoqëritë si dhe legjislacionit në Republikën e Shqipërisë.

## **9. Neni 9. Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve**

9.1. Secili prej ortakëve ka dhe ushtron të drejtën e votës në asamblenë e përgjithshme të ortakëve ("Asambleja e Përgjithshme") në proporcion me vlerën e kuotës përkatëse të zotëruar në kapitalin e Shoqërisë, të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejta të tjera të parashikuara nga ky Statut, Ligjit të Shoqërive dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

9.2. Secilit prej Ortakëve do t'i jepet pas kërkesës me shkrim të këtij të fundit drejtar administratorit të Shoqërisë, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë dhe veprimtarinë financiare, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentet dhe raportet e Shoqërisë. Ky informacion duhet t'i paraqitet ortakut të interesuar nga administratori i Shoqërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës përkatëse.

9.3. Në rast të transferimit të kuotës ose çdo pjese të saj tek ortakët e tjerë të Shoqërisë, të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i kësaj kuote ose çdo pjese të saj fillojnë të ushtrohen nga momenti i njoftimit të Shoqërisë për këtë transferim.

9.4. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj dhe Ortakët mbajnë përgjegjësi deri në vlerën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

9.5. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakëve të saj.

9.6. Secili prej ortakëve të Shoqërisë duhet:

- të zbatojë dispozitat e këtij Statuti, vendimet e organeve drejtuese të Shoqërisë, të marra në funksion të kompetencave përkatëse;
- të marrë pjesë në vendimmarjet e nevojshme për vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në Republikën e Shqipërisë, nëse pjesëmarrja e tij është e domosdoshme për miratimin e vendimit;
- të mos kryejë veprime (mosveprime) të cilat vështirësojnë thelbësish ose si pasojë e të cilave arritura/kryerja e qëllimeve përfshirë të cilat është krijuar Shoqëria bëhen të pamundur.

## **10. Neni 10. Transferimi i kuotës ose pjesëve të saj**

10.1. Transferimi i kuotës përkatëse ose pjesëve të saj të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë një ose disa ortakëve të Shoqërisë ose një apo disa personave të tretë kryhet me shitje, trashëgimi, dhurim ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

10.2. Transferimi i kuotës të secilit prej ortakëve të Shoqërisë mund të kryhet vetëm përfshirë deri në pjesën e shlyer të saj.

10.3. Në rast transferimi të kuotës ose pjesëve të saj tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, me shitje, dhurim apo çdo formë tjetër kalimi tek persona të tretë, ortaku që synon të transferojë kuotën përkatëse ose pjesë të saj duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë nëpërmjet Shoqërisë vullnetin e tij me shkrim. Njoftimi duhet të përbajë çmimin, vlerën e kuotës përfshirë tu transferuar dhe kushtet të tjera të rëndësishme të transferimit. Njoftimi i ortakëve të Shoqërisë kryhet nga organi ekzekutiv - administratori – i Shoqërise.

10.4. Secili prej ortakëve të tjerë zotëron ushtrimin e së drejtës së parablerjes së kuotës transferuese nga ortaku transferues sipas çmimit të ofruar përfshirë persona të tretë dhe kushteve të tjera të barabarta, proporcionalisht me përqindjen e zotëruar në kapitalin e Shoqërisë.

10.5. Secili prej ortakëve të Shoqërisë ka të drejtë ta ushtrojë të drejtën e parablerjes brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim nga Shoqëria nëpërmjet organit e kzekutiv - administratorit. Në rast mos-ushtrimi të së drejtës së parablerjes së ortakëve Brenda afatit kohor të sipërpërmendur, transferimi i kuotës ose pjesës së saj do të ndahet proporcionalisht me ortakët që kanë shprehur interesin e tyre dhe kanë ushtruar të drejtën e parablerjes.

10.6. Në rast se asnjë nga ortakët ekzistues nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes për kuotën ose pjesë të saj në kapitalin e Shoqërisë, kuota ose pjesa e saj object transferimi mund të transferohet tek persona të tretë sipas çmimit dhe kushteve të njoftuara Shoqërisë në organin ekzekutiv-administratorit si dhe ortakëve të Shoqërisë.

## **KREU IV**

### **11. Neni 11. Kompetencat, kuorumi dhe vendimmarria**

11.1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi më i lartë kontrollues dhe vendimmarrës i Shoqërisë, e cila merr vendime në mbledhje të zakonshme dhe jashtëzakonshme.

11.2. Asambleja e përgjithshme e ortakëve mblidhet jo më vonë se dy muaj pas mbylljes së viti finansiar ushtrimor nga organi ekzekutiv – administratori i Shoqërisë. Në këtë mbledhje, përveç të tjerave, miratohen rezultatet vjetore të veprimtarisë së Shoqërisë.

11.3. Asambleja e përgjithshme e zakonshme e ortakëve vendos me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve fizikisht pjesëmarrës në asamble pasi të jetë arritur kuorumi i kërkuar prej 51% të të gjithë ortakëve zotërues të kuotave me të drejtë vote në kapitalin e Shoqërisë (“shumica e thjeshtë”).

11.4. Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me shumicë të thjeshtë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- 1) përcaktimin e qëllimeve kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe miratimin e vendimeve në lidhje me pjesëmarrjen/bashkimin në organizime dhe shoqëri të tjera tregtare;
- 2) miratimin e politikave tregtare, plan-biznesit, planit të financimit dhe buxhetit;
- 3) marrja e vendimeve në lidhje me krijimin e filialeve dhe përfaqësive, si dhe marrjen e vendimeve në lidhje me krijimin e shoqërive bija;
- 4) emërimi, përzgjedhja dhe shkarkimi i ekspertëve kontabël të miratuar ose likuidatorëve, si dhe përcaktimi i shpërblimit për shërbimet e ekspertit kontabël të miratuar apo likuidatorëve;
- 5) mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të politikave tregtare, plan biznesit, përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë nga administratori Shoqërisë;
- 6) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dh e bilancit vjetor;
- 7) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve; dhe

8) çështje të tjera të parashikuara në këtë Statut ose në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

11.5. Asambleja e përgjithshme e jashtëzakonshme e ortakëve vendos me një shumicë prej  $\frac{3}{4}$  e ortakëve fizikisht pjesëmarrës në mbledhje pasi të jetë arritur kuorumi i kërkuar prej 70% e të gjithë ortakëve zotërues të kuotave me të drejtë vote në kapitalin e Shoqërisë (“shumica e kualifikuar”).

11.6. Nëse vendimi në mbledhjen e jashtëzakonshme të ortakëve nuk mund te kalohet për shkak se nuk arrihet shumica e kualifikuar, atëherë mbledhja mblidhet përsëri në ditën e 15 (pesëmbëdhjetë) pas shpërndarjes së asamblesë së parë për të marrë vendim me të njëtin rend dite.

11.7. Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me shumicë të kualifikuar në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- 1) ndryshimin e Statutit të Shoqërisë, si dhe ndryshimin e kapitalit të Shoqërisë;
- 2) përfaqësimin e Shoqërisë përpara gjykatës si dhe çështjet gjyqësore kundër administratorit;
- 3) marrjen e vendimeve lidhur me shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë midis ortakëve të saj;
- 4) marrjen e vendimeve lidhur me pezullimin e aktivitetit te Shoqërisë, ri-organizimin ose likuidimin e Shoqërisë;
- 5) vlerësimin e kontributeve në natyrë, në mungesë të ekspertëve vlerësues të emëruar, sipas nenit 68/6 të Ligjit të Shoqërive;
- 6) zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- 7) përcaktimin e kufijve të transaksioneve me vlerë të konsiderueshme për tu zbatuar nga organet ekzekutive-administratori i Shoqërisë si dhe përcaktimi i të gjithë kushteve thelbësore për kryerjen e këtyre;
- 8) çdo çështje tjetër lidhur me veprimtarinë e Shoqërisë, të parashikuara në këtë Statut dhe/ose legjislacioni në Republikën e Shqipërisë.

11.8. Asambleja e përgjithshme e Shoqërisë merr vendime të vlefshme vetëm për pikat e rendit të ditës, për të cilat ortakët e Shoqërisë janë njoftuar rregullisht, me përashtim të rasteve kur në mbledhjen përkatëse të ortakëve marrin pjesë të githë ortakët dhe vendosin me unanimitet për marrjen e vendimeve.

## **12. Neni 12. Thirrja e mbledhjes së përgjithshme**

12.1. Asambleja e përgjithshme mund te thirret nga organi ekzekutiv – administratori ose nga secili prej ortakëve të Shoqërisë.

12.2. Asambleja e përgjithshme thirret nga organi ekzekutiv – administratori Shoqërisë, me kërkesë të ekspertit kontabël dhe me kërkesë të ortakëve të Shoqërisë. Organ i ekzekutiv-administratori jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së asamblesë njofton secilin prej ortakëve të Shoqërisë për mbledhjen e ortakëve nëpërmjet postës elektronike ose shërbimit postar me postë rekomande në adresat e deklaruara nga secili prej ortakëve dhe të regjistruar në librat e Shoqërisë.

12.3. Njoftimi duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e takimit të mbledhjes së asamblesë së ortakëve si dhe rendin e ditës përkatës të mbledhjes së ortakëve. Secili prej ortakëve, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e caktuar e mbledhjes, ka tëdrejtë të propozojë përfshirjen e çështjeve shtesë në rendin e ditës. Nëse bazuar në këto propozime të ortakëve të Shoqërisë ndryshon rendi i ditës, organi ekzekutiv – administrator duhet të njoftojë të gjithë ortakët e Shoqërisë Brenda dy ditëve nga dita e caktuar e mbledhjes për ndryshimet në rendin e ditës sipas parashikimeve të pikës 12.2 të këtij nenit.

12.4. Asambleja e përgjithshme mblidhet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër, Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, siç njoftohet ortakëve nga organi ekzekutiv – administrator i Shoqërisë. Vendimet e Shoqërisë, regjistrohen nga organi ekzekutiv – administratori në librin e vendimeve të ortakëve të Shoqërisë, libër ky që mbahet në selinë e Shoqërisë nën kujdesin e organit ekzekutiv – administratorit.

12.5. Në rast se asambleja e përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me kërkesat e këtij nenit, kjo e fundit mund të marrë vendime të vlefshme vetëm me pjesëmarjen në mbledhje dhe vendimin unanim të gjithë ortakëve të Shoqërisë

### **13. Neni 13. E drejta e pjesëmarjes në mbledhjen e asamblesë**

13.1. Secili prej ortakëve ka të drejtë përmarrë pjesë në mbledhjet e asamblesë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit me autorizim të thjeshtë në përputhje me nenin 85 të Ligjit të Shoqërive.

13.2. Organ i ekzekutiv – administratori – nuk mund të përfaqësojë ortakët e Shoqërisë në mbledhjen e përgjithshme.

13.3. Ortakët ose përfaqësuesit e tyre mund të jenë të pranishëm në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, me kusht që të sigurohet identifikimi i pjesëmarjes së të pranishëmve në kohë reale të komunikimit të ndërsjellë, duke i dhënë mundësinë ortakëve që të diskutojnë dhe vendosin mbi çështjet e rendit të ditës. Në këtë rast, asambleja e përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes, të ngarkuar me detyrën e mbajtjes dhe nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes.

### **KREU V**

**14. Neni 14. Administratori**

14.1. Drejtimi i veprimtarisë aktuale të Shoqërisë kryhet nga organi drejtues – administratori. Në cilësinë e administratorit mund të veprojë vetëm një individ.

14.2. Administrator i Shoqërisë është:

- Z. Edjon Doçi, shtetas i Republikës së Shqipërisë, lindur më 29.06.1986, në Macukull, Mat, me pasaportë nr. BJ6221551, ID: 031743568, me vendbanim në adresën: rruga Don Bosko, kompleksi Vizion Plus, hyrja 2, ap. 47, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

14.3. Kohëzgjatja e mandatit të administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, me të drejtë ripërtëritje.

14.4. Ortakët kanë të drejtë të shkarkojnë administratorin me shumicë të thjeshtë votash.

**15. Neni 15. Kompetencat dhe detyrimet**

15.1. Kompetencat e administratorit të Shoqërisë në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- 1) përfaqësimin e Shoqërisë gjatë aktivitetit të përditshëm;
- 2) drejtimin e aktivitetit tregtar të Shoqërisë dhe zbatimi i rregulloreve të brendshme dhe planeve /politikave të miratuara në asamblenë e përgjithshme;
- 3) thirrjen e asamblesë se përgjithshme sipas këtij Statuti;
- 4) mbikëqyrjen për mbajtjen ne mënyrë të rregullt të librave dhe pasqyrave kontabël të Shoqërisë;
- 5) sigurimin e përgatitjes dhe nënshkrimin e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së Shoqërisë se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimit që i paraqiten për miratim asamblesë së përgjithshme;
- 6) raportimin përpara asamblesë se përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe planeve, si dhe mbi realizimin e transaksioneve dhe lidhjen e marrëveshjeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- 7) kryerjen e detyrate dhe përgjegjësive të tjera të përcaktuara në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, këtë statut dhe me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve të Shoqërisë.

**Kapitulli VI**

**16. Neni 16. Viti ushtrimor finançiar**

16.1. Viti ushtrimor finançiar fillon në ditën e parë të muajit janar dhe përfundon në ditën e tridhjetë e një të muajit dhjetor të secilit vit. Përjashtimisht, për vitin e parë të aktivitetit të Shoqërisë, viti ushtrimor finançiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin kombëtar tregtar mbajtur nga QendraKombëtare e Regjistrimit në Republikën e Shqipërisë dhe përfundon më datë tridhjetë e një dhjetor të atij viti.

**17. Neni 17. Riorganizimi dhe likuidimi i Shoqërisë**

17.1. Shoqëria mund të riorganizohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve sipas dispozitave të Ligjit të Shoqërise, legjisacionin e Republikës së Shqipërisë, me vullnetin e Shoqërisë si dhe për çdo shkak tjetër të parashikuar në legjisacionin e Republikës së Shqipërisë.

17.2. Riorganizimi i Shoqërisë mund të kryhet në formën e shkrirjes, bashkimit, ndarjes, veçimit dhe ristrukturimit në përputhje me Ligjin për Shoqëritë dhe legjisacionin e Republikës së Shqipërisë.

17.3. Shoqëria mund të likuidohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve sipas parashikimeve të Ligjit për Shoqëritë ose për çdo shkak tjetër mbi likuidimin/prishjen e Shoqërisë të parashikuar në ligj. Shoqëria mund të likuidohet/prishet me vendim gjyqësor sipas parashikimeve të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë dhe legjisacionin e Republikës së Shqipërisë.

17.4. Asambleja e përgjithshme e ortakëve që vendos për likuidimin e Shoqërisë duhet të emërojë një ose më shumë likuidatorë, të cilët marrin përsipër të gjithë të drejtat dhedetyrimet e përfaqësimit dhe drejtimit të veprimeve në emër të Shoqërisë.

**18. Neni 18. Dispozita përfundimtare**

18.1. Për çdo çështje tjetër, e cila nuk rregullohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

18.2. Ky Statut hartohet në 2 kopje.

**Ortakët e Shoqërisë**

**Z. Edjon DOÇI** 

**Z. Dmitri SHUBIN**   
Përfaqësues me prokurë  
Edjon DOÇI  
**Z. Levon GEVORGYAN**   
Përfaqësues me prokurë  
Edjon DOÇI

Dt. 06/12/2019